



**VENDIM**

**Nr. 93 Datë 28.07.2015**

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË HEC KABASH POROCAN SH.P.K. NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC –  
ET “HOLTA KABASH” DHE “HOLTA POROCAN” ME FUQI TË  
INSTALUAR PÛRKATËSISHT 2.2 MW DHE 3.3 MW, (ME FUQI TOTALE  
5.5 MW)**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 germa a të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.07.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC KABASH POROCAN” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

1. Shoqëria “HEC KABASH – POROCAN” sh.p.k ka aplikuar për tu pajisur me licensë për prodhimin e energjisë elektrike në datën 13.05.2015 në zbatim të Ligjit nr. 9072, datë 23.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 76, datë 08.06.2015, miratoi fillimin e procedurave për prodhimin e energjisë të shoqërisë “HEC KABASH – POROCAN” sh.p.k.
2. Njoftimi i kërkesës për licencim të këtij subjekti është kryer ne zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 9072 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar.
3. Në datën 15.05.2015 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
4. Në Ligjin nr 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që Ligji nr 9072 datë 22.05.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, shfuqizohet.

5. Në Ligjin nr 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vete ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të tij, në nenin 110 pika 2 të tij parashikohet se : *Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.*

Për sa më sipër dhe duke qënë se aplikimi i shoqërisë “HEC KABASH POROCAN” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “HEC KABASH POROCAN” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Holta Kabash” me fuqi të instaluar 2.2 MW dhe “Holta Porocan” me fuqi të instaluar 3.3 MW, (me fuqi totale të instaluar 5.5 MW), për një afat 30 – vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

**Petrit Ahmeti**

Në mungesë dhe me porosi

**Adriatik BEGO**